

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Hani i Elezit – Raporti komunal

Tetor 2009

Hani i Elezit në shifra

Popullsia	Gjithsej	10,000
	Shqiptarë	99%
	Boshnjak	1%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	83
	Numri i fshatrave	10
Shkollimi	Nr. i nxënësve	2077
	Nr. i mësimdhënësve	89
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	5
	Nr. i çerdheve	0
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	1
	Nr. i mjekëve	4
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	6,100
	Të punësuar në sektorin publik komunal	190
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	1,153,143
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	73,400
	Të hyrat tjera (Euro)	1,079,743
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	846,263 (87%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	172,198 (62%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	674,065 (97%)
Kryetar i Komunës	2005-2007: Mallzum Qajani	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Hanin e Elezit

Në shekullin e XIX, Elez Dimca ndërtoi një han në vendbanimin që deri më atëherë njihej si Sar. Pas ndërtimit të hanit, ky rajon gjerësisht filloi të njihej me emërtimin e ri Hani i Elezit. Hani i Elezit, dikur pjesë e Komunës së Kaçanikut, përbëhet nga 10 fshatra dhe një njësi urbane. Kjo komunë ka një shtrirje gjeografike të veçantë, ku vendbanimi urban gjenden në mes të një grope gjeografike, kurse fshatrat gjenden përreth në lartësi mbidetare nga 400 deri 800 metra lartësi. Hani i Elezit është njëra ndër tri komunat e reja, të cilat janë formuar më 2005. Si komunë në vete Hani i Elezit është themeluar me Urdhëresën Administrative 2005/11 me datë 27 shtator 2005. Neni 2 i kësaj urdhërese kërkon themelimin e pesë pilot-njësive të komunave brenda komunave pjesë e së cilave kanë qenë. Kësisoj në bazë të kësaj urdhërese u formua komuna e Junikut, Parteshit, Hanit të Elezit, Mamushës dhe Graçanicës. Përderisa Graçanica dhe Parteshi nuk pranuar që të mëvetësohen si komuna, tri komunat tjera filluan funksionimin e tyre. Edhe pse e formuar që nga 2005, qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit nuk kanë pasur ende shansin që të votojnë për komunën e tyre. Përderisa më 15 nëntor komunat e tjera do të mbajnë zgjedhjet për herë të katërt që nga viti 2000, Hani i Elezit do të mbaj zgjedhje për herë të parë.

Problemet aktuale

Banorët e kësaj komune përballen me problemet që janë karakteristikë e tërë qytetarëve të Kosovës, siç janë papunësia dhe varfëria. Përveç këtyre problemeve të përgjithshme, qytetarët e kësaj komune përballen edhe me probleme si:

- Mungesa e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat rurale;
- Ndotja e lumit Lepenc;
- Mungesa e hapësirave të gjelbëruara;
- Mungesa e sinjalit të televizionit publik.

Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen banorët e kësaj komune të re, është rrjeti i ujësjellësit. Edhe pse në qendrën urbane të kësaj komune gjendja me furnizim me ujë konsiderohet e mirë, edhe pse me shumë reduktime, banorët e pjesëve rurale të kësaj komune nuk kanë qasje fare në rrjet të ujësjellësit. Gjatë vitit 2009 komuna ka një plan për shpimin e një pusi tek vendi Puset e Nikës, si dhe në bashkëpunim me CDI parashihet filtrimi i ujit të përroskës së Dimces. Mirëpo këto dy projekte nuk parashihet se do të zgjidhin problemin, as për qytetit e aq më pak për fshatrat. Banorët e fshatrave detyrohen që vetë të sigurojnë burimet e ujit, të cilat janë të kushtueshme. Situata më e rëndë me ujë të pijes vërehet në fshatrat Dromjak, Krivenik, Neçavcë, Vërtomicë, etj. Lokalitetet rurale nuk posedojnë as rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza.

Mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat rurale. Rrugët në pjesët rurale të kësaj komune janë në gjendje jo të mirë dhe nuk janë të asfaltuara. Gjatë dy viteve të fundit, me mjete të komunës është bërë asfaltimi i rrugës Seqishtë-Krivenik dhe është bërë asfaltimi i rrugës në qendër të qytetit. Fshatrat nuk i kanë aspak rrugët e rregulluara.

Ndotja e lumit Lepenci. Për shkak të ujërave të zeza që derdhen në lum dhe mbetjet e fabrikës "Silcapor", lumi Lepenc është i ndotur në shkallë të lartë. Lumi Lepenc i

cili burimin e ka në malet e Sharrit, në komunën e Kaçanikut ka një shtrirje prej 8,5 km.

Mungesa e hapësirave të gjelbëruara. Komuna e Hanit të Elezit, si një komunë industriale, përkundër pozitës së mirë gjeografike që ka dhe një gjelbërimi natyral, ka mungesë të hapësirave të rregulluara gjelbëruese në qytet. Sidomos vërehet mungesa e parqeve dhe vendeve rekreative në qytet. Qytetarët më të moshuar dëshirojnë që kohën e lirë të tyre ta kalojnë në ndonjë park, por të cilin nuk e kanë deri më tani.

Mungesa e sinjalit të televizionit publik. Edhe pse banorët e kësaj komune detyrohen që të paguajnë 3.5 € në muaj për televizionin publik, ata nuk kanë sinjal për të parë programet e këtij televizioni. Qytetarët më shumë i rëndon fakti se ata duhet të paguan për një shërbim që nuk e marrin. Edhe pse ky është një problem që mund të zgjidhet vetëm nga niveli qendror (Kuvendi i Kosovës), qytetarët kërkojnë një aleancë me pushtetin lokal që të kenë një zë më të fuqishëm për atë që televizioni publik të shtrijë sinjalin edhe në këtë pjesë të Kosovës.

Kuvendi Komunal dhe kryetari i komunës

Komuna e Hanit të Elezit së pari ka filluar së funksionuari si pilot-njësi në shtator 2005. Me formimin e komunës në shtator, u bë edhe emërimi i përfaqësuesve në Kuvendin Komunal dhe zgjedhja e kryetarit të Kuvendit Komunal. Kryetar u zgjodh Mallzum Qajani, deri atëherë nënkryetar i Komunës së Kaçanikut. Në Kuvendin komunal prej 15 anëtarësh u emëruan 6 anëtarë të PDK, 6 të LDK, një i AAK dhe dy nga shoqëria civile. Koalicioni qeverisës përbëhet nga PDK-AAK dhe një pjesëtar i shoqërisë civile. Pas funksionimit tre vjeçar si pilot njësi komunale, Hani i Elezit në gusht 2008 morri statusin e komunës dhe kryetar u zgjodh sërish Mallzum Qajani.

Formimi i komunës së re u ka lehtësuar shumë punën qytetarëve të kësaj komune, për shkak se kryerja e shërbimeve komunale dhe marrja e dokumentacioneve është më e lehtë dhe më afër se më parë.

Në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, kjo komunë edhe pse për dy vite funksiononte si njësi në vete, qytetarët e Hanit të Elezit votuan si pjesë e Komunës së Kaçanikut. Zgjedhjet e vitit 2009 janë zgjedhjet e para në historinë e kësaj komune të re. Të drejtë vote më 15 nëntor 2009 kanë 7,680 qytetarë.

Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2008 ka qenë 846,263. Deri në fund të vitit 2008, janë shpenzuar 87% e këtyre mjeteve. Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake për 2008, Hani i Elezit ka treguar performancë të mirë në këtë drejtim dhe ka arritur të arkëtoj 108.29% të mjeteve të planifikuara. Buxheti i vitit 2009 në total kap shumën prej 1,153,143 €. Nga kjo shumë, të hyrat vetanake përbëjnë vetëm 6.3% të buxhetit të përgjithshëm.

Investimet kapitale

Pasi që kapacitetet financiare të Komunës së Hanit të Elezit janë të vogla, mjetet e ndara për investime kapitale gjithashtu nuk janë të mjaftueshme. Në 2008 mjetet e ndara për investime kapitale kapnin shumën prej 181,811 €; kurse në vitin 2009 mjetet e destinuar për investime kapitale kapin shumë prej 343,678 €. Tabela më poshtë paraqet katër nga projektet më të mëdha të cilat janë planifikuar të kryhen për këto dy vite.

Tab.1.: Investimet kapitale në Hani i Elezit gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit-Seqishtë-Kryen.	€21,666
2008	Asfaltimi i rrugës Qendra-Banesa e re-Park	€10,000
2008	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Gorancë	€10,000
2009	Asfaltimi i rrugës Prroji i Rezanës	€45,000

Përkundër shumës së vogël të mjeteve të destinuar për investime kapitale, Komuna e Hanit të Elezit ka treguar menaxhim të dobët në shpenzimin e këtyre mjeteve. Deri në fund të shtatorit 2008, vetëm 7% e mjeteve të destinuar për investime kapitale ishin përdorur. Mjetet e shpenzuara kishin të bënin vetëm me hartim të planeve dhe bashkëfinancim në projekte të ndryshme. Deri në fund të vitit 2008, u shpenzuan 62% të këtyre mjeteve. Kurse në 2009, në gjashtëmuorin e parë, janë shpenzuar 12.8% e mjeteve të destinuar për investime kapitale

Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna Hanit të Elezit do të ketë në dispozicion 1,226,372 € për investime kapitale.

Tab.2.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hani i Elezit 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	1,241,893	1,268,294	1,310,027
Të hyrat vetanake në €	127,921	131,983	135,790
Investimet kapitale në €	356,881	415,199	454,292

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Hanit të Elezit për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 1.6 milion € për investime kapitale.

Administrata komunale

Në sektorin publik komunal të Hanit të Elezit (arsim, shëndetësi, administratë) janë të punësuar 190 punonjës. Vetëm në administratë janë të punësuar 32 shërbyes civil. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2009), asnjë administratë komunale nuk duhet të ketë më pak se 55 punonjës. Numri prej 55 punonjësve është konsideruar si i nevojshëm për plotësimin e të gjitha pozitave në të gjithë sektorët komunal. Komunës së Hanit të Elezit i duhet që të punësoj staf deri të arrij shifrën prej 55 punonjësish.

Tab.3. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Hani i Elezit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	190 ▲
2008	159
2007	160 ▲
2006	15 ■

Komuna Hani i Elezit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Gjatë vitit 2008, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit ka mbajtur dhjetë mbledhje të rregullta, aq sa kërkohet minimumi me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kurse në gjashtë mujorin e parë të 2009, KK i Hanit të Elezit ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Deri më tani KK ka miratuar 2 rregullore komunale. Komiteti për Politikë dhe Financa si komiteti më i rëndësishëm komunal ka mbajtur 11 mbledhje gjatë 2008, dhe gjashtë mbledhje në pjesën e parë të 2009.

Kryetari i Komunës ka mbajtur 4 tubime publike me qytetarë gjatë 2008. Gjatë këtyre dy viteve nuk ka pasur asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare si dhe asnjë petition.

Hani i Elezit ka edhe uebfaqen zyrtare në internet. Ueb faqes së komunës së Hanit të Elezit i mungojnë një sërë informacionesh ashtu që një qytetari do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës siç janë: projektet komunale, shërbimet komunale, si dhe legjislacioni komunal nuk është i paraqitur në ueb faqe në masën e duhur. Pamja vizuale e ballinës është mjaftë e mirë.

Tab.4. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Hanit të Elezit (www.hanielezi-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	3.33
Shërbimet komunale	2.40
Info rreth qytetit	3.5
Projektet komunale	1.75
Lajme & lajmërim	1
Harta e faqes	5
Kontakt	5
Gjuhët	2
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	2.75
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	17

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Gjendja në arsim

Në Komunën e Hanit të Elezit nuk funksionon asnjë çerdhe. Sa i përket shkollimit fillor dhe të mesëm, në këtë komunë funksionojnë pesë shkolla fillore (3 shkolla amë dhe dy paralele të ndara) dhe një shkollë e mesme. Sa i përket hapësirës shkollore, kjo komunë ka nevojë për ndërtimin e objekteve të reja shkollore. Komuna ka hartuar planin dhe ka caktuar lokacionin (Lagjja e Re) për ndërtimin e një objekti të ri shkollor në qytet. Sa i përket shkollës së mesme, qytetarë ankohen se në të mungon rregulli, disiplina dhe rezultatet e mira. Shkolla e mesme ka rreth 402 nxënës në 12 paralele të ndara dhe ka 19 mësimdhënës. Raporti në mes nxënësve dhe mësimdhënësve është 21.2.

Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Hanit të Elezit funksionojnë dy institucione shëndetësore: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Han të Elezit dhe ambulanca në fshatin Guranë. Komuna ndjen mungesën e mjekëve specializant. Tani së fundmi janë angazhuar dy specialist të mjekësisë familjare, njëri nga Ferizaj. Lista esenciale e barnave nuk është e furnizuar me rregull, ashtu si edhe në komunat tjera të Kosovës.

Shoqëria civile

Si komunë e re, në Hanin e Elezit as shoqëria civile nuk ka arrit që të etablohet dhe të jetë pjesë e jetës publike. Kur Hani i Elezit është formuar si komunë me vete me udhëzim administrativ të PSSP më 2005, 2 nga 15 anëtarët e Kuvendit Komunal u caktuan qytetarë që nuk janë pjesë e partive politike. Por ata nuk janë as pjesë e shoqërisë civile, nëse me këtë nënkuptojmë një grup të organizuar legal që avokon çështje me rëndësi për komunën. Organizata e vetme aktive në këtë komunë është "Progresi për Demokraci".

Mediat lokale

Në Komunën e Hanit të Elezit nuk është i regjistruar asnjë medium lokal. Qytetarët nuk kanë sinjal as të televizionit dhe radios publike, kurse disa kanë sinjal vetëm të Radio Kaçanikut. Komuna nuk ka as korrespondentë me qëndrim të përhershëm në këtë komunë. Gazetat ditore kanë korrespondentët e tyre në Kaçanik, të cilët herë pas here mbulojnë edhe ndonjë ngjarje me rëndësi në komunën e Hanit të Elezit.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit në shtator të këtij viti ka miratuar

Rregulloren mbi tatimin në pronë për vitin 2010. Sipas kësaj rregulloreje tatimi në pronë llogaritet në bazë të katër zonave dhe normat tatimore sillen nga 0.05% deri 0.20%.

Tab.5.Tatimi në pronë në Komunën Hani i Elezit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.10%	0.20%	0.20%	0.05%
I	300 €	300 €	500 €	150 €	120 €
II	300 €	250 €	400 €	150 €	100 €
III	-	200 €	300 €	150 €	80 €
IV	-	150 €	250 €	150 €	80 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Hani i Elezit konsiderohet si komunë industriale. Në këtë komunë funksionon fabrika më e njohur e prodhimit të çimentos në Kosovë. Përveç kompanive publike, shumica e së cilave janë privatizuar apo janë dhënë me koncesion, në Han të Elezit funksionojnë edhe një numër i konsiderueshëm i bizneseve private. Në këtë komunë janë të regjistruara rreth 250 biznese të vogla dhe të mesme. Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit me 6 prill 2009 ka miratuar Rregulloren Komunale për Tarifa dhe ngarkesa administrative, sipas së cilës ka përcaktuar çmimet për leje për secilin biznes veç e veç. Më poshtë i kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe çmimi që ato duhet të paguajnë për leje pune në çdo komunë.

Tab.9. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	1,000 €
Kompanitë e sigurimit	400 €
Terminali doganor	1,500 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	1,200 €
Bastoret sportive	400 €
Agjensionet turistike	50 €
Klubet e natës	400 €
Motelet	300 €
Supermarketet-Hipermarketet	300 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	200 €
Kafeteritë	100 €
Restorant	300 €
Telekomunikimit	50 – 200 €
Depot	200- 350 €
Autoshkollat	100 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 – 100 €

Barnatoret	200 €
Pompat e benzinës	1,000 €
Ndërmarrjet ndërtimore	300 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	100 - 200 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoha dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
7. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
8. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
9. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
11. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
14. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.